



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE - NATYRORE

PROGRAMI MASTER NË SHKENCË KOMPJUTERIKE

Prishtinë 2022

Tabela e lëndëve

Viti I						
Semestri I			Orë/Javë			
Nr	O/ Z	Lënda	L	U	ECT S	Mësimdhënësi
1	O	Hyrje në shkencën e të dhënave	2	2	6	Dr. Sc. Ermir Rogova
2	O	Kalkulus i avancuar	2	2	6	Dr. Sc. Behar Baxhaku
3	O	Statistikë e avancuar	2	2	6	Dr. Sc. Edmond Aliaga
4	O	Metodologjia e hulumtimit shkencor	3	1	6	Dr. Sc. Armend Shabani
5	Z	Inteligjenca artificiale	2	2	6	Dr. Sc. Eliot Bytyçi
6	Z	Programim funksional	2	2	6	Dr. Sc. Faton Berisha
Gjithsej semestri I			11	8	30	
<i>Sqirim: studenti zgjedh një lëndë zgjedhore, përveç në rastet kur në studimet BSc nuk ka ndjekur lëndën Inteligjenca Artificiale , atëherë kjo bëhet obligative.</i>						
Semestri II			Orë/Javë			
Nr	O/ Z	Lënda	L	U	ECT S	Mësimdhënësi
1	O	Seminar	3	1	6	Dr. Sc. Faton Berisha
2	O	Algjebër e avancuar	2	2	6	Dr. Sc. Armend Shabani
3	O	Të mësuarit e makinës	2	2	6	Dr. Sc. Ercan Canhas
4	O	Siguria dhe privatësia e informacioneve	2	2	6	Dr. Sc. Artan Berisha
5	Z	Marketingu i gjelbër dhe përgjegjësia sociale	2	2	6	Dr. Sc. Ejup Fejza
6	Z	Shkenca kompjuterike dhe shoqëria	3	1	6	Dr. Sc. Eliot Bytyçi
Gjithsej semestri II			12	6	30	
Viti II						
Semestri III			Orë/Javë			
Nr	O/ Z	Lënda	L	U	ECT S	Mësimdhënësi
1	O	Të dhënat e shumta (big data)	2	2	6	Dr. Sc. Ermir Rogova
2	O	Kompjutimi në cloud	2	2	6	Dr. Sc. Artan Mazrekaj
3	O	Ndërmarrësia	2	2	6	Dr. Sc. Ejup Fejza
4	Z	Analiza e rrjetave	2	2	6	Dr. Sc. Faton Berisha
5	Z	Kompjutimi me performancë të lartë	2	2	6	Dr. Sc. Valon Raça
6	Z	Informatat në web	2	2	6	Dr. Sc. Arben Damoni
7	Z	Procesimi i imazheve	2	2	6	Dr. Sc. Artan Berisha
Gjithsej semestri III			11	8	30	
Semestri IV			Orë/Javë			
Nr	O/ Z	Lënda	L	U	ECT S	Mësimdhënësi
1	O	Tema e masterit			30	
Gjithsej semestri IV					30	

Përshkrimi i shkurtër i lëndëve

Semestri 1

Lënda: Hyrje në shkencën e të dhënave (2+2) 6 ECTS

Statusi i lëndës: Obligative

Mësimdhënësi: Prof. Asoc. Dr. Ermir Rogova

Përshkrimi i shkurtër: Lënda është një përmbledhje hyrëse e temave të rëndësishme për shkencën e të dhënave. Temat e mëposhtme do t'u paraqiten studentëve përmes leksioneve nga anëtarët e fakultetit dhe leksioneve të ftuara nga industria dhe institucionet kërkimore: Puna me të dhëna: Marrja Përpunimi. Ruajtja. Pastrimi. Përmbledhja. Vizualizimi. Analizat: Parashikimi. Grumbullimi. Përfundimi (inference) statistikor. Aspektet e biznesit dhe shoqërisë: Privatësia. Siguria. Etika. Licencimi. Pronë intelektuale. Praktikat (mjetet) më të mira: Standardet e programimit, kodimit (Python). Versionimi (Github). Riprodhueshmëria (Jupyter). Editor për shkrim (LaTeX). Arkivat publike (ArXiv, Zenodo).

Qëllimet e lëndës: Studenti do të njohë të gjitha aspektet kryesore të shkencës së të dhënave. Studenti do të mësojë si të përdorë mjetet e softuerit, të menaxhojë të dhëna, të paraqesë të dhëna dhe të analizojë të dhëna. Studenti gjithashtu do të njihet me aspekte të tjera praktike, etike, të sigurisë dhe privatësisë të punës në shkencën e të dhënave. Qëllimi i kursit është të lejojë kontaktin e studentit me praktikën e mira nga industria dhe kërkimi. Vizitorë nga industria dhe institucionet kërkimore do të përfshihen në leksione. Qëllimi i kësaj është që studentët të takojnë disa profesorë dhe këshilltarë të mundshëm nga fusha të ndryshme, ndërsa shembujt praktikë do ta motivojnë studentin për studim.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që:

- Menaxhojnë të dhëna.
- Zgjedhin vizualizimin e duhur.
- Përdorin mjete themelore të programimit për shkencën e të dhënave.
- Përdorin modele themelore të machine learning dhe statistikave.
- Përgatitin një raport shembullor.
- Të njohin çështjet e mundshme të sigurisë, privatësisë dhe etikës kur punojnë me të dhëna.
- Zgjedhin një licencë të përshtatshme për punë dhe softuer.
- Zbatojnë praktika të mira të shkencës së të dhënave

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, ushtrime, kuize, punime seminarike, diskutime dhe konsultime.

Metodat e vlerësimit:

- Punime seminarike dhe kuize 30%;

- Kollokfiumi i parë 35%,
- Kollokfiumi i dytë 35%
- Provimi final 70% (në vend të kollokimeve, nëse rezultatet e kollokfiumeve nuk janë te kënaqshme)

Kriteret e vlerësimit:

Pikët	Nota
0 deri 50	5
51 deri 62	6
63 deri 74	7
75 deri 86	8
87 deri 98	9
99 deri 100	10

Mjetet e konkretizimit/TI: Markerit, shpuza, tabela, laboratorit i kompjuterëve, projektorit.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1:1

Literatura:

- Perez-Riverol Y, Gatto L, Wang R, Sachsenberg T, Uszkoreit J, Leprevost FdV, et al. (2016) Ten Simple Rules for Taking Advantage of Git and GitHub. PLoS Comput Biol 12(7): e1004947.
- Sandve GK, Nekrutenko A, Taylor J, Hovig E (2013) Ten Simple Rules for Reproducible Computational Research. PLoS Comput Biol 9(10): e1003285.
- Osborne JM, Bernabeu MO, Bruna M, Calderhead B, Cooper J, Dalchau N, et al. (2014) Ten Simple Rules for Effective Computational Research. PLoS Comput Biol 10(3): e1003506.
- Zook M, Barocas S, boyd d, Crawford K, Keller E, Gangadharan SP, et al. (2017) Ten simple rules for responsible big data research. PLoS Comput Biol 13(3): e1005399.
- Hart EM, Barmby P, LeBauer D, Michonneau F, Mount S, Mulrooney P, et al. (2016) Ten Simple Rules for Digital Data Storage. PLoS Comput Biol 12(10): e1005097.

Lënda: Kalkulus i avancuar (2+2) 6 ECTS

Statusi i lëndës: Obligative

Mësimdhënësi: Prof. Ass. Dr. Behar Baxhaku

Përshkrimi i shkurtër: Në këtë lëndë do të studiohen: vektorët, drejtëzat, rrafshet dhe parametrizimi i kurbave dhe sipërfaqeve; derivatet parcialet, derivatet e drejtuara dhe gradienti si vektor, optimizimi dhe analiza e pikës kritike, duke përfshirë metodën e shumëzuesit të Lagranzhit; integrimi mbi lakoret, sipërfaqet dhe mbi një zonë të çfarëdoshme duke përdorur koordinatat polare, cilindrike dhe sferike; fushat vektoriale, dhe integralet sipas vijave dhe sipërfaqeve për punë dhe fluks; divergjenca dhe rotori i fushave vektoriale së bashku me aplikimet.

Qëllimet e lëndës: Studenti të aftësohet që të përgjithësojë konceptet për funksionin me një variabël në funksionet me shumë variabla dhe që njohuritë e fituara përmes këtij kursi të mund t'i zbatojë si një aparaturë ndihmëse në studimet e lëndëve të shkencës kompjuterike.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të:

- Përdorin metoda të ndryshme të optimizimit në problemet e 'Machine learning';
- Përdorin funksionet vektoriale për të studiuar kurbat në hapësirë, si edhe aplikime të tjera të Fizikës dhe inxhinjerisë;
- Llogarisin derivatet duke përdorur rregullin zinxhir ose diferencialet totale;
- Aplikojnë njohuritë e marra në mënyrë të pavarur në zgjidhjen e problemeve teknike dhe shkencore në shkencën kompjuterike dhe informacionit;
- Llogarisin integralet e shumëfishta në koordinata polare, cilindrike dhe sferike;
- Kuptojnë, si bëhet ndërrimi i radhës së integritimit dhe i teoremave kryesore (Grintit, Stoksit, Gausit) të kursit dhe aplikimet fizike të këtyre teoremave.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, seminare, diskutime, ushtrime, konsultime, detyra shtëpie, kolloqfiume, provimi përfundimtar.

Metodat e vlerësimit: Punimi seminarik dhe detyra të shtëpisë (20%), Vlerësimi i parë periodik (20%), Vlerësimi i dytë periodik (10%), Testi final (50%).

Mjetet e konkretizimit/TI: Lapsi, tabela, projektori dhe kompjuteri.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1:1

Literatura:

- 1 Ron Larson Bruce H Eduards, Multivariable Calculus, Cengage Learning, 2016.
- 2 James Stewart, Calculus, Early Transcendentals, Thomson, 2008.
- 3 J. Callahan, Advanced Calculus, Lecture Notes, Smith College, USA, 2011.

Lënda: Statistikë e avancuar (2+2) 6 ECTS

Statusi i lëndës: Obligative

Mësimdhënësi: Prof. Ass. Dr. Edmond Aliaga

Përshkrimi i shkurtër: Temat që do të trajtohen: Hyrje në statistikat e Bayes-it, Gjeneruesit e numrave të rastit, Zinxhirët e Markovit, metoda Monte Carlo, Mostrat e refuzimit, Mostrat Gibbs – algoritmi MCMC, Algoritmi Metropolis-Hasting, Modelimi hierarkik, Modele të zgjedhjeve diskrete, Modele të serive kohore, Proceset e Gausit.

Qëllimet e lëndës: Qëllimi kryesor i kësaj lënde është njohja e studentit me statistikat e Bayes-it, mënyrën e aplikimit të statistikave të Bayes-it, si dhe algoritmet themelore e teknikat llogaritëse që i bëjnë statistikat e Bayes-it praktikisht të realizueshme.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të zgjidhin detyra tipike statistikore;
- Zgjedhin një model të përshtatshëm për analizën statistikore;
- Interpretojnë rezultatet statistikore;
- Arsyetojnë zgjedhjet e tyre të modelimit.
- Përgatisin një raport statistikor;
- Përdorin metoda MCMC të përshtatshme;
- Hartojnë variante të reja të modeleve standarde statistikore.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, detyra shtëpie, kollokuiume, provimi përfundimtar.

Metodat e vlerësimit: Punimi seminarik (10%), detyra të shtëpisë (10%), projekti real (25%), Testi final (55%).

Mjetet e konkretizimit/TI: Lapsi, tabela, projektori dhe kompjuteri.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: 1:1

Literatura:

1. Hoff, P. D., *A first course in Bayesian statistical methods*. Springer Science & Business Media, (2009).
2. Kadane, J. B., *Principles of uncertainty*. CRC Press, (2011).
3. Kruschke, J., *Doing Bayesian data analysis: A tutorial with R, JAGS, and Stan*. Academic Press, (2014).
4. Gelman, A., Carlin, J. B., Stern, H. S., Dunson, D. B., Vehtari, A., & Rubin, D. B., *Bayesian data analysis*. CRC press, (2013).

Lënda: Metodologjia e hulumtimit shkencor (3+1) 6 ECTS

Statusi i lëndës: Obligative

Mësimdhënësi: Prof. Ass. Dr. Eliot Bytyçi

Përshkrimi i shkurtër: Kjo lëndë fokusohet në zhvillimin e aftësive hulumtuese dhe shkruese në Shkencë Kompjuterike. Pjesët kryesore të saj janë:

1. Metododat empirike dhe zbatimi i tyre në probleme hulumtuese
2. Konceptet e ndërlidhura me shkencat e tjera
3. Metodologjitë hulumtuese: të mirat dhe të metat e tyre

Qëllimet e lëndës: Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me idetë themelore, sfidat, teknikat dhe problemet gjatë hulumtimit shkencor .

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti është i aftë që:

- Për të futur metodologjitë e hulumtimit dhe kërkimit në shkencë kompjuterike
- Për të kuptuar pikat e forta dhe të dobëta të secilës prej këtyre metodave.
- Si të zgjidhni metodën/at e përshtatshme për hulumtimet?
- Si të kryeni hulumtime duke përdorur këto metoda?
- Cilat janë kërcënimet që lidhen me këto metoda dhe si të merremi atëherë me to.
- Raportimi i rezultateve të këtyre hulumtimeve.
- Shkrimi i artikujve teknikë / punimeve kërkimore.
- Kuptimi i roleve të autorëve, vlerësuesve. Si të rishikoni artikujt e hulumtimit?

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata dhe punë individuale në projekte/detyra/seminare.

Metodat e vlerësimit: Punë seminarike: 30%, Detyra/Projekte individuale (total: 70%): Detyra/Projekti 1: 35% dhe Detyra/Projekti 2: 35%

Mjetet e konkretizimit/TI: Lapsi, tabela, projektori dhe kompjuteri.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 3:1

Literatura:

1. *Research Design. Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods Approaches.* By John W. Creswell, Fourth Edition. SAGE Publication, 2014
2. *The Craft of Research,* By Wayne C. Booth, Gregory G. Colomb, Joseph M. Williams , Joseph Bizup, William T. FitzGerald, Third Edition, The University of Chicago Press, 2008
3. *The Elements of Style.* William Strunk Jr. and E. B. White, Forth Edition, Pearson, 1999
4. *Research Methodology* By Panneerselvam R, 2nd Edition, PHI, 2014

Lënda: Inteligjenca Artificiale (2+2) 6 ECTS

Statusi i lëndës: Zgjedhore

Mësimdhënësi: Prof. Ass. Dr. Eliot Bytyçi

Përshkrimi i shkurtër: Kjo lëndë prezanton konceptet kryesore të Inteligjencës Artificiale. Pjesët kryesore të saj janë:

- Themelet e inteligjencës artificiale dhe lidhja me shkencat tjera
- Zgjidhja e problemeve me anë të agjentëve
- Metodatat e bazuara në njohuri dhe metodatat e bazuara në kërkim për zgjidhjen e problemit dhe nxjerrjen e konkluzioneve
- Komunikimi përmes modeleve të ndryshme gjuhësore

Parakushtet: Lëndë nga programimi, njohuri nga logjika matematike.

Qëllimet e lëndës: Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me idetë themelore, sfidat, teknikat dhe problemet në inteligjencën artificiale.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti është i aftë që:

- Të diskutojë parimet klasike të inteligjencës artificiale
- Të shpjegojë strategjitë kryesore të kërkimit.
- Të zbatojë këto koncepte në zhvillimin e aplikacioneve dhe algoritmeve efikase për sistemet inteligjente.
- Të analizojë çështjet që lidhen me performancën në inteligjencën artificiale.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, ushtrime laboratorike dhe punë individuale në projekte/detyra/seminare.

Metodat e vlerësimit: Punë seminarike: 10%, Detyra/Projekte individuale (total: 40%): Detyra/Projekti 1: 20% dhe Detyra/Projekti 2: 20%, Provimi final: 50%

Mjetet e konkretizimit/TI: Lapsi, tabela, projektori dhe kompjuteri.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1:1.

Literatura:

1. Russell & Norvig , Artificial Intelligence: A Modern Approach , Prentice Hall, 3rd edition.
2. Punime të ndryshme nga fusha e Inteligjencës Artificiale.

Lënda: Programim funksional (2+2) 6 ECTS

Statusi i lëndës: Obligative

Mësimdhënësi: Prof. Dr. Faton Berisha

Përshkrimi i shkurtër: Kursi ofron një hyrje gjithpërfshirëse në fushën e programimit funksional. Kursi do të prekë disa nga metodat e analizës programore dhe teoritë mbështetëse, si dhe teknikat dhe aplikacionet bashkëkohore.

Qëllimet e lëndës: Qëllimi kryesor i kursit është një ekspozitë mbi fundamentet e programimit të pastër funksional dhe zbatimin e koncepteve të programimit funksional për kodim efikas në gjuhët kryesore programuese.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të kursit studentët do të jenë në gjendje të:

- Të kuptojnë parimet themelore të programimit të pastër funksional dhe të zgjidhin probleme duke zbatuar këto parime.
- Të jenë në gjendje të kodojnë në gjuhën programuese funksionale Haskell.
- Të investigojnë, verësojnë dhe krahasojnë programe në Haskell për nga korrektësia sintaksore dhe semantike, përgjithësimi, rishfrytëzueshmëria, efikasiteti dhe vetitë performuese.
- Të zbatojnë teknikat e programimit funksional në paradigmen e orientuar nga objektet në gjuhën programuese Java..

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata hyrëse, diskutime dhe detyra laboratorike.

Metodat e vlerësimit: Provimi periodik: 30%, provimi përfundimtar: 40%, detyrat laboratorike: 30%.

Mjetet e konkretizimit /TI: Mjetet standarde të konkretizimit dhe laboratorit kompjuterik.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: 1:1

Literatura:

- S. Thompson, *Haskell: The Craft of Functional Programming*, Addison-Wesley/Pearson, 2011.
- B. C. Pierce, *Types and Programming Languages*. MIT Press, 2002.
- F. Nielson, H. R. Nielson, C. Hankin, *Principles of Program Analysis*, Springer, 2010.

Semestri 2

Lënda: Seminar (3+1) 6 ECTS

Statusi i lëndës: Obligative

Mësimdhënësi: Prof. Dr. Faton Berisha

Përshkrimi i shkurtër: Në këtë kurs studentët do të zgjedhin temën e seminarit dhe punojnë në grupe për të përfunduar atë. Studentët paraqesin progresin dhe rezultatet e tyre afatmesme. Studentët përfundojnë projektin me një prezantim publik të punës së tyre. Temat e projekteve përpilohen nga pedagogu nga propozimet e anëtarëve të fakultetit dhe industrisë.

Qëllimet e lëndës: Qëllimi kryesor i kursit është që studentët të zbatojnë njohuritë e marra në kurse të tjera në një projekt përkatës të shkencës kompjuterike.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që:

- Kombinoni procedurat, metodat dhe mjetet e paraqitura në kurse të tjera.
- Planifikoni një projekt të hulumtimit dhe zhvillimit të shkencës së të dhënave.
- Organizoni punën në ekip.
- Shpjegoni zgjedhjen e tyre të metodave dhe mjeteve të nevojshme në projekt.
- Vlerësoni në mënyrë kritike punën e tyre dhe punën e tjetrit.
- Mbrojnë punën dhe rezultatet e tyre përpara një paneli ekspertësh të të dhënave.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata hyrëse, diskutime dhe rishikimi projekteve.

Metodat e vlerësimit: Rishikimi intermediar: 50%; Rishikimi përfundimtar: 50%.

Mjetet e konkretizimit /TI: Lapsi, tabela, projektori dhe kompjuteri.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: 3:1

Literatura:

- Përcaktohet nga bartësi i lëndës në varësi të seminareve

Lënda: Algjebër e avancuar (2+2) 6 ECTS

Statusi i lëndës: Obligative

Mësimdhënësi: Prof. Ass. Dr. Armend Shabani

Përshkrimi i shkurtër: Në këtë kurs do të përfshijmë sa vijon:

Hyrje në algjebërën lineare. Transformimet lineare dhe afine. Norma vektoriale dhe matricore. Format kuadratike. Matricat pozitive semidefinite. Dekompozimi Cholesky. Teorema Perron-Frobenius.

Qëllimet e lëndës: Qëllimi i kursit është të thellojë kuptimin e studentëve për formulimin e problemeve që vijnë nga 'Machine Learning' me metodat e Algjebërës Lineare.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që:

- të kuptojnë teorinë e hapësirave vektoriale, bazën dhe dimensionin, shumat e drejtëperdrejta dhe produktet;
- të kuptojnë transformimet lineare dhe korrespondencën ndërmjet transformimeve lineare dhe matricave, vlerave vetjake dhe vektorëve vetjak, diagonalizimit të matricave;
- të kuptojnë Matricat pozitive semidefinite, dekompozimin e Cholesky, dhe Teoremën Perron-Frobenius;
- të ndërtojnë aftësi për të aplikuar njohuritë e marra në mënyrë të pavarur në zgjidhjen e problemeve nga 'Machine Learning'.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjerata, ushtrime, detyra të shtëpisë. Fokusi qëndron në punën e vazhdueshme me detyrat e shtëpisë, punën individuale duke përdorur kompjuterin dhe softuerin e optimizimit.

Metodat e vlerësimit: Vlerësimi i vazhdueshëm (detyra shtëpie, vlerësimi në mes të semestrit) - 50%; Provimi përfundimtar (provim me shkrim ose me gojë) - 50%.

Mjetet e konkretizimit /TI: Lapsi, tabela, projektori dhe kompjuteri.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: 1:1

Literatura:

- Charu C. Aggarwal, *Linear Algebra and Optimization for Machine Learning*, Springer, 2020
- Marc Peter Deisenroth, A. Aldo Faisal, Cheng Soon Ong, *Mathematics for Machine Learning*, Cambridge University Press, 2020

Lënda: Të mësuarit e makinës (2+2) 6 ECTS

Statusi i lëndës: Obligative

Mësimdhënësi: Prof. Asoc. Dr. Ercan Cahani

Përshkrimi i shkurtër: Kjo lëndë prezanton konceptet kryesore të të mësuarit e makinës. Pjesët kryesore të saj janë:

Pasqyra e metodave të të mësuarit të makinës,

Masat e avancuara të vlerësimit tëtributeve

Metodat e avancuara për vlerësimin e performancës dhe vizualizimit

Kombinimi i algoritmeve të të mësuarit të makinës

Rrjetet nervore artificiale

Të mësuarit pa mbikëqyrje: grumbullimi, rregullat e shoqërimit

Parakushtet: Lëndë nga programimi, njohuri nga matematike.

Qëllimet e lëndës: Qëllimi i kësaj lënde është të paraqesë bazat dhe parimet themelore të metodave të të mësuarit e makinës (ML), algoritmet themelore të saj dhe përdorimin e tyre në praktikë për zbulimin e njohurive nga të dhënat, gjurmimin e të dhënave dhe për klasifikimin e të mësuarit dhe modelet e regresionit.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti është i aftë që:

- të jetë në gjendje të përdorë ekspertizën e disa teknikave dhe metodave, të përdorura për modelimin e të dhënave me të mësuarit e makinës

- të jetë në gjendje të analizojë dhe parashikojë zgjidhjeve dhe pasojat e tyre për problemet e synuara duke përdorur metodologjinë shkencore.

- të jetë në gjendje të përdorë metodat e paraqitura për problemet e synuara nga mjedisi shkencor dhe i biznesit. Do të kuptojë dhe përdorë mjetet për modelimin dhe gjurmim të të dhënave.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, ushtrime laboratorike dhe punë individuale në projekte/detyra/seminare.

Metodat e vlerësimit: Punë seminarike: 10%, Detyra/Projekte individuale (total: 40%): Detyra/Projekti 1: 20% dhe Detyra/Projekti 2: 20%, Provimi final: 50%

Mjetet e konkretizimit/TI: Lapsi, tabela, projektori dhe kompjuteri.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1:1.

Literatura:

1. David J. Hand, Heikki Mannila, Padhraic Smyth: Principles of Data Mining. The MIT Press, 2001.

2. Ian H. Witten, Eibe Frank: Data Mining: Practical Machine Learning Tools and Techniques. Morgan Kaufmann, 1999.

Lënda: Siguria dhe privatësia e informacionit (2+2) 6 ECTS

Statusi i lëndës: Obligative

Mësimdhënësi: Dr. Sc. Artan Berisha

Përshkrimi i shkurtër: Lënda përfshin aspekte të rëndësishme të sigurisë dhe privatësisë së informacionit si: Standardet dhe organizatat kryesore (ISO, ITU-T, IETF, W3C, OASIS, OMA). Mekanizmat e sigurisë, shërbimet e sigurisë (parimet dhe zbatimet praktike të vërtetimit, konfidencialitetit, integritetit, mos-mohimit, kontrollit të hyrjes, regjistrimit dhe alarmimit), infrastruktura e çelësit publik (baza kohore, menaxhimi i hapësirës së emrit, protokollet operacionale), bazat e llogaritjes kuantike (shkëmbimi i çelësit kuantik). Autentikimi, autorizimi dhe infrastruktura e kontabilitetit (parimet, shembuj të zgjidhjeve të standardizuara si RADIUS dhe Diametri). Siguria e shtresave fizike dhe të dhënave (shembuj të protokolleve janë WEP, WPA1 dhe WPA2). Siguria e rrjetit, transportit dhe shtresave të aplikimit, përfshirë internetin e gjërave dhe reve (shembuj të protokolleve janë IPsec, TLS, S / MIME, SET, XMLSec, SAML, XACML, WS- *). Metodatat formale (taksonomia e metodave zyrtare, shembuj si metoda e R. Rueppel, BAN logjike). Menaxhimi i privatësisë dhe privatësia nga dizajni (rrjetet sensorë, sistemet RFID) me bazat e menaxhimit të besimit dhe reputacionit në arkitektura të orientuara drejt shërbimeve. Programimi i sigurt (kontrolli i modelit). Menaxhimi i rrezikut në IS, pikëpamjet organizative dhe pikëpamjet e faktorit njerëzor (politikat e sigurisë, modelimi i faktorit njerëzor dhe simulimet). Akreditimi dhe auditimi i IS në lidhje me sigurinë (ISO 2700X, CISSP), dhe standardet për implementimin teknik të komponentëve të harduerit dhe softuerit (Kriteret e Përbashkët). Legjislacioni bazë në fushën e sigurisë dhe privatësisë së IS (direktivat e BE, implementimet kombëtare).

Qëllimet e lëndës: Qëllimi i kursit është të edukojë studentët që të jenë në gjendje të sigurojnë në mënyrë aktive siguri dhe privatësi në sistemet bashkëkohore të informacionit, qofshin ato si administratorë të sistemeve, ose zhvillues të zgjidhjeve të reja.

Kompetencat e kategorizuara:

- Zhvillimi i aftësive në mendimin kritik, analitik dhe sintetik .
- Aftësia për të përcaktuar, kuptuar dhe zgjidhur sfidat krijuese profesionale në shkencën kompjuterike dhe të informacionit.
- Aftësia e komunikimit profesional në gjuhën amtare, si dhe në një gjuhë të huaj.
- Pajtueshmëria me parimet e sigurisë, funksionale, ekonomike dhe mjedisore.
- Aftësia për të kuptojnë dhe zbatojnë njohuritë e shkencave kompjuterike dhe të informacionit në fusha të tjera teknike dhe përkatëse (ekonomi, shkencë organizative, arte figurative, etj.) .
- Njohuri dhe aftësi praktike të pajisjeve kompjuterike, softuerëve dhe teknologjisë së informacionit të nevojshme për punë të suksesshme profesionale në shkencën kompjuterike dhe të informacionit.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që:

- zhvillojnë zgjidhje më të thjeshta në këtë fushë,
- të jenë të kualifikuar për auditim të brendshëm të sigurisë dhe privatësisë,
- të jenë në gjendje të përcaktojnë politikën e sigurisë.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, ushtrime, kuize, punime seminarike, diskutime dhe konsultime

Metodat e vlerësimit:

- Punime seminarike dhe kuize 30%,
- Kollokfiumi i parë 35%,
- Kollokfiumi i dytë 35%
- Provimi final 70% (në vend të kollokumeve, nëse rezultatet e kollokfiumeve nuk janë te kënaqshme)

Pikët nga puna laboratorike dhe kollokfiumet mbledhen dhe vlerësohen sipas kriterëve të mëposhtme:

Pikët	Nota
0 deri 50	5
51 deri 62	6
63 deri 74	7
75 deri 86	8
87 deri 98	9
99 deri 100	10

Mjetet e konkretizimit/TI: Markerit, shpuza, tabela, laboratorit i kompjuterëve, projektorit.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1:1

Literatura:

- D. Trček: Information Systems Security and Privacy, Springer, New York, Heidelberg, 2006.
- D. Trček, Informacijska varnost in zasebnost, kopije prosojnic, FRI UL 2017/2018.
- Publikime të zgjedhura dhe burime online.

Lënda: Marketingu i gjelbër dhe përgjegjësia sociale (2+2) 6 ECTS

Statusi i lëndës:Zgjedhore

Mësimdhënësi: Prof. Asoc. Dr. Ejup Fejza

Përshkrimi i shkurtër: Studentët në ligjëratën hyrëse do të mësojnë për 4P, elementet e marketingut miks, kurse më tutje në këtë lëndë do të arrijnë të mësojnë më shumë rreth përparësive që krijon njohja e mirë e këtyre elementeve të marketingut miks dhe lidhja e tyre me marketingun e gjelbër dhe përgjegjësinë sociale, si urë lidhëse me konsumatorin e ndërgjegjësuar për mbrojtje të ambientit dhe kontributin në shoqëri dhe komunitet nga ndërmarrjet prodhuese ose shërbyese.

Qëllimet e lëndës: Kjo lende ka synim kryesor të pajisë studentet me njohuritë e nevojshme që lidhen me marketingun e gjelbër dhe përgjegjësinë sociale si shtylla të një zhvillimi të qëndrueshëm të ndërmarrjes në treg. Programi është konceptuar në mënyrë që studentet të marrin njohuri të thelluara në drejtim të këtyre dy kahjeve si një koncept bashkohor.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që:

- Te kuptojnë dallimin në mes të marketingut tradicional dhe marketingut të gjelbër
- Te kuptojnë rolin e përgjegjësisë sociale për ndërmarrjen
- Analizojnë përfitimet nga marketingu i gjelbër dhe përgjegjësia sociale për një zhvillim të qëndrueshëm të ndërmarrjes
- Nepermjet menaxhimit të mirë të lidhjes në mes marketingut të gjelbër dhe përgjegjësisë sociale mund të krijojnë rritje në performancën e biznesit
- Të promovojnë, në praktikë dhe sot si student, efektet pozitive të marketingut shoqëror në rritjen e qëndrueshme të ndërmarrjes.
- Aplikojnë në praktikë konceptin e 3 P (planet, people, profit) dhe të 3 R (reduce, reuse, recycle)

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratë, diskutime, konsultime, punim seminarik, provimi përfundimtar.

Metodat e vlerësimit: Punimi seminarik dhe (25%), Testi final (75%).

Mjetet e konkretizimit/TI: Lapsi, tabela, projektori dhe kompjuteri.

